



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 15**

**18 shkurt**

**2014**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.8481 datë 10.2.2014	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	301
Urdhër i MTI nr. 66, datë 20.1.2014	Për delegim kompetence.....	301
Urdhër i MM nr. 321, datë 11.2.2014	Për përfundimin e periudhës kalimtare, në kryerjen e funksioneve të dhëna, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nga ligji nr. 10 448, datë 9.6.2011 “Për lejet e mjedisit”.....	302
Kërkesë e MTI nr.715, datë 10.2.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i “Furnizimit me ujë i plazheve Durrës-Kavajë (nga pusshpimet e Çermës, degëzimi në Kavajë deri në depon e re Arapaj”, loti III).....	302

**DEKRET**  
**Nr.8481, datë 10.2.2014**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Edlira Tomorr Kotorri (Hoxha)
2. Jesika Veton Kotorri
3. Pamela Veton Kotorri
4. Kristi Albert Deetjen (Myftiu)
5. Orestia Gjon Kapidani
6. Armand Genc Bega
7. Marla Armand Bega
8. Dora Vasillaq Tili

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**

**URDHËR**  
**Nr. 66, datë 20.1.2014**

**PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr.8485, datë 15.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa "a", të vendimit nr.997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Autoritetit Rrugor Shqiptar jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr.997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar.



3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS  
**Edmond Haxhinasto**

### **URDHËR**

**Nr. 321, datë 11.2.2014**

### **PËR PËRFUNDIMIN E PERIUDHËS KALIMTARE, NË KRYERJEN E FUNKSIONEVE TË DHËNA, AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT, NGA LIGJI NR. 10 448, DATË 9.6.2011 “PËR LEJET E MJEDISIT”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të nenit 4 dhe të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 29.1.2014 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit”,

### **URDHËROJ:**

1. Përfundimin e periudhës kalimtare në kryerjen e funksioneve Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të dhëna nga ligji nr. 10 448, datë 9.6.2011 “Për lejet e mjedisit”.
2. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për leje mjedisi të tipit “A” dhe “B” do të realizohet vetëm nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, urdhri nr. 908, datë 14.10.2013 “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të kërkesave për pajisje me leje mjedisore”, shfuqizohet. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT  
**Lefter Koka**

### **KËRKESË**

**Nr. 715, datë 10.2.2014**

### **PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i “Furnizimit me ujë i plazheve Durrës-Kavajë (nga pusshpimet e Çermës, degëzimi në Kavajë deri në depon e re Arapaj”, loti III).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin

e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruar me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e tokës bujqësore, me sipërfaqe 5481.5 m<sup>2</sup>, është 1 858 228.5 (një milion e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e tetë pikë pesë) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS  
Edmond Haxhinasto**

**LISTA E PRONARËVE DHE MASA E SHPËRBLIMIT  
PËR SECILIN PRONAR SIPAS DOKUMENTEVE TË DORËZUARA NË DPUK**

<b>Nr.</b>	<b>Emri, mbiemri</b>	<b>Zona kadastrale</b>	<b>Nr. i pasurisë</b>	<b>Arë (m<sup>2</sup>)</b>	<b>Çmimi (lekë)</b>	<b>Vleftha (lekë)</b>
1	Sabri Kacmoli	1031	119/11	3700.9	339	1,254,605.10
2	Ramazan Kacmoli	1031	119/14	1780.6	339	603,623.4
				5481.5		1,858,228.5
<b>Shuma (lekë)</b>						<b>1,858,228.5</b>

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 8 lekë